

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. DHIMITËR LARA

05/29/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 27.05.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimiter Lara, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 29.05.2019 me shumicë votash vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Dhimitër Lara, gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Firdes Shuli relatores, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.